

Tiranë, më datë _____. 2026

KËRKESË

KËRKUES:

1. Besjana Guri, e bija e [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
2. Blendi Salaj, i biri i [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
3. Ersid Domnori, i biri i [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
4. Gentiana Kapllani, e bija e [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
5. Gezim Shuli, i biri i [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
6. Irini Myftaraj, e bija e [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
7. Joniada Ngjelo, e bija e [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
8. Lazjon Petri, i biri i [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
9. Mateo Yskollari, i biri i [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
10. Migena Kukli, e bija e [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
11. Oljam Dërvishi, i biri i [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED];
12. Rikaldo Çelaj, i biri i [REDACTED], lindur më datë [REDACTED], lindur në [REDACTED], madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal [REDACTED], (në vijim të gjithë kërkuesit referohen si "Grupi Nismëtar").

DREJTUAR:

Z. Ilirjan CELIBASHI
Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

LËNDA:

1. Kërkesë për miratimin e procedurave për mbajtjen e referendumit për shfuqizimin e Ligjit nr. 21/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura'".
2. Kërkojmë pajisjen e Grupit Nismëtar me formularët tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50,000 zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve.

BAZA LIGJORE:

Neni 150 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Nenet 118, 126 dhe 127 të Ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
Neni 19 i Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

I Nderuar Z. Celibashi,

Ne, një grup qytetarësh të vetëdijshëm për rrezikun që i kanoset trashëgimisë sonë natyrore dhe biodiversitetit të vendit nga zbatimi i Ligjit nr. 21/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura'", mbështetur në nenin 150 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ju drejtohem me këtë kërkesë për fillimin e procedurave për mbajtjen e një referendumi shfuqizues për shkaqet si më poshtë vijon:

Më datë 4.5.2017, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura" ("Ligji nr. 81/2017").¹ Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mbrojtje të veçantë të përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në këto zona, përmes: (i) shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore; (ii) zhvillimit dhe mbrojtjes së zonave të mbrojtura mjedisore, pasurive kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit, si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm; (iii) lehtësimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe promovimin e vlerësimit dhe shërbimeve të ekosistemeve; dhe (iv) informimit dhe edukimit të publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura. Nga ana tjetër, në referim të nenit 1 të Ligjit nr. 81/2017, një nga objektivat e tij është jo vetëm ruajtja, evidentimi, përcaktimi, rehabilitimi, ripërtëritja e zonave të mbrojtura, por edhe zgjerimi i tyre.

Pavarësisht sa më sipër, më datë 22.2.2024, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 21/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura'" ("Ligji nr. 21/2024"),² i cili çënon qëllimin e mbrojtjes së habitateve natyrore në disa drejtime.

Së pari, Ligji nr. 21/2024 shton në nenin 3, pika 25/1, konceptin e "turizmit të ekselencës", i përkufizuar si ofrimi i akomodimit në struktura me standardet më të larta arkitektonike dhe mjedisore, si dhe ofrimi i shërbimeve turistike ekskluzive. Në dukje, ky përkufizim synon promovimin e një zhvillimi turistik cilësor dhe të qëndrueshëm. Në realitet, nëpërmjet këtij formulimi krijohet baza justifikuese për lejimin e ndërtimit të strukturave akomoduese me karakter të mirëfilltë ndërtimor edhe brenda zonave të mbrojtura, një qasje që bie ndesh me vetë frymën, qëllimin dhe objektivat themelore të legjislacionit për zonat e mbrojtura, i cili synon ruajtjen e ekosistemeve, të habitateve natyrore dhe të vlerave mjedisore të veçanta, jo transformimin e tyre në territore për zhvillim turistik intensiv.

¹ Ligji nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura", Fletore Zyrtare nr. 116, datë 23.5.2017.

² Ligji nr. 21/2024, Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura', Fletore Zyrtare nr. 50, datë 20.3.2024.

Së dyti, Ligji nr. 21/2024 zëvendëson gjithashtu terminologjinë e qartë ndaluese të legjislacionit të mëparshëm, si “nuk lejohet”, “ndalohej” apo “përjashtohet” me nocione më elastike, si “kufizim”, “zhvillim i qëndrueshëm” apo “strategji menaxhimi”. Në praktikë, këto formulime krijojnë hapësira të gjera interpretimi, duke relativizuar regjimin mbrojtës të zonave të mbrojtura dhe duke mundësuar ndërhyrje infrastrukturore dhe investime me voium të konsiderueshëm ndërtimor. Nëpërmjet këtyre mekanizmave, sipërfaqe të konsiderueshme të zonave të mbrojtura rrezikojnë të shndërrohen gradualisht në teritore të destinuara për zhvillime turistike intensive, përfshirë ndërtimin e resorteve, duke cenuar qëllimin themelor të mbrojtjes së tyre.

Së treti, ndryshe nga neni 33 i Ligjit nr. 81/2017, i cili e kushtëzonte lejimin e veprimtarive në zonat e mbrojtura me parashikimet e Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, plane që dilnin si rezultat i konsultimeve të gjata publike me qytetarët dhe grupet e interesit, Ligji nr. 21/2024 ia ka kaluar përcaktimin e veprimtarive të lejueshme, rast pas rasti, Këshillit të Ministrave. Kjo zgjeron ndjeshëm kompetencat e pushtetit ekzekutiv dhe redukton rolin e mekanizmave të pjesëmarrjes publike në procesin e vendimmarrjes. Konkretisht, neni 33, pika 2, e Ligjit nr. 21/2024 parashikon se lejohen “veprimtari të zhvilluara në struktura akomoduese të ekselencës, 5 yje ose më shumë, në fushën e turizmit, dhe çdo veprimtari/infrastrukturë tjetër mbështetëse ose në funksion të tyre, pavarësisht nëse kjo përcaktohet në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur.” Kjo dispozitë krijon një përjashtim të posaçëm nga regjimi i përgjithshëm mbrojtës, duke lejuar ndërtime dhe zhvillime turistike edhe në rastet kur ato nuk janë parashikuar në aktin fillestar të shpalljes së zonës së mbrojtur. Në vend që të mbetet një rast i kufizuar, ky përjashtim rrezikon të shndërrohet në rregull të përgjithshëm aplikimi, duke dobësuar vetë karakterin mbrojtës të ligjit. Për shkak të referimit të përsëritur tek neni 33, ky mekanizëm përshkon të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura, duke rrezikuar transformimin e tyre nga teritore me regjim të posaçëm mbrojtjeje në teritore të destinuara për zhvillime intensive ndërtimore dhe turistike.

Kjo qasje bie ndesh edhe me angazhimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë. Sikundërse konstatohet në Pozicionin e Përbashkët të Bashkimit Evropian mbi Grupkapitullin 4, miratimi dhe zbatimi i Ligjit nr. 21/2024 ka ngritur shqetësime për shkak të lejimit të investimeve masive turistike dhe industriale në zonat e mbrojtura, duke krijuar rrezikun e pashmangshëm të dëmtimit të vlerave ekologjike dhe të biodiversitetit të Shqipërisë, përfshirë dhe zonat e mundshme Natura 2000,³ në kundërshtim me standardet evropiane të mbrojtjes së habitateve natyrore, të cilat kërkojnë që çdo plan apo projekt të autorizohet vetëm pasi autoritetet të kenë identifikuar të gjitha ndikimet e mundshme mbi objektivat e ruajtjes, në dritën e njohurive më të mira shkencore, dhe vetëm nëse nuk mbetet asnjë dyshim i arsyeshëm shkencor për mungesën e efekteve negative.⁴

Për më tepër, Ligji nr. 21/2024 çënon drejtpërdrejt biodiversitetin e vendit në kuptimin e tij material. Zonat e mbrojtura shqiptare strehojnë ekosisteme e habitate me vlerë të lartë ekologjike, shpesh unike apo me shkallë të lartë endemizmi, të karakterizuara nga ekuilibra të brishtë. Ndërtimi i strukturave “të ekselencës” dhe i infrastrukturës mbështetëse sjell në mënyrë të pashmangshme fragmentim habitatesh, prishje të korridoreve ekologjike e migratore, rritje të presionit mbi burimet ujore e tokësore, ndotje dhe shqetësim të specieve të egra, si dhe humbje të shërbimeve ekosistemike nga të cilat përfitojnë të gjithë qytetarët. Për shkak të natyrës së pakthyeshme të shumë prej këtyre

³ <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/AD-15-2025-INIT/en/pdf>

⁴ Çështja C-404/09, Komisioni kundër Spanjës, datë 13.01.2012, para. 99; Çështja C-182/10, Solvay dhe të Tjerë, datë 16.02.2012, para. 67.

dëmeve, zhdukja e një specije apo shkatërrimi i një habitati parësor nuk riparohet dot përmes asnjë kompensimi financiar.

Përsa më sipër, në kushtet kur Ligji nr. 21/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura'" çënon në mënyrë të drejtëpërdrejtë biodiversitetin e vendit, duke shkaktuar dëmtime të pakthyeshme të ekosistemit; dhe Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur në rrezik rezikon aspiratën e qytetarëve shqiptarë që Shqipëria të jetë një Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian përmes miratimit të këtij ligji, dhe mos shfuqizimit të tij si një nga "benchmarks" për mbylljen e negociatave për Kapitullin 27 të negociatave, Grupi Nismëtar kërkon shfuqizimin e këtij ligji përmes referendumit.

Pyetja që kërkojmë të shtrohet për referendum përpara shtetasve me të drejtë vote në Republikën e Shqipërisë është:

A duhet të shfuqizohet Ligji Nr. 21/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura'"?

Ndaj, në përmbushje të së drejtës torë të parashikuar nga neni 150 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kërkojmë:

1. Miratimin e procedurave për mbajtjen e referendumit për shfuqizimin e Ligjit nr. 21/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura'".
2. Pajisjen e Grupit Nismëtar me formularët tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50,000 zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve.

Me konsideratë,
GRUPI NISMËTAR

Besjana GURI

Blendi SALAJ

Ersid DOMNORI

Gentiana KAPLLANI

Gezim SHULI

Irini MYFTARAJ

Joniada NGJELO

Lazjon PETRI

Mateo YSKOLLARI

Migena KUKLI

Oljam DËRVISHI

Rikaldo ÇELAJ

Ju lutemi, gjëni bashkëlidhur:

- Shtojca 1: Gjeneralitetet e anëtarëve të Grupit Nismëtar;
- Shtojca 2: Mjetet e identifikimit të anëtarëve të Grupit Nismëtar;
- Shtojca 3: Procesverbal "Për krijimin e Grupit Nismëtar për mbledhje firmash për referendum";
- Shtojca 4: Prokurë për përfaqësuesin e Grupit Nismëtar.